“O djalosh, po t'i mësoj disa fjalë: “Ruaje Allahun, që Ai të të ruajë ty! Ruaje Allahun, që ta kesh pranë! Kur të lypësh, lypi Allahut, e kur të kërkosh ndihmë, kërko nga Allahu!

Ebul Abasi, Abdullah ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Një ditë, ndërsa isha mbrapa të të Dërguarit të Allahut më tha: “O djalosh, po t'i mësoj disa fjalë: “Ruaje Allahun, që Ai të të ruajë ty! Ruaje Allahun, që ta kesh pranë! Kur të lypësh, lypi Allahut, e kur të kërkosh ndihmë, kërko nga Allahu! Gjithashtu, dije se, edhe nëse të gjithë njerëzit do të mblidheshin për të të bërë mirë, nuk do të munden të të bëjnë mirë, pos asaj që ta ka caktuar Allahu, dhe anasjelltas; nëse bashkohen për të të bërë dëm, nuk do të mund të të dëmtojnë, përveç asaj që ta ka caktuar Allahu. Tashmë lapsat janë ngritur dhe fletët janë tharë.” Në një transmetim tjetër, krahas të Tirmidhiut, thuhet: “Ruaje Allahun, që ta kesh para vetes! Bëhu i njohur tek Allahu kur të jesh në rehati, që të të njohë kur të jesh në vështirësi! Gjithashtu, dije se ajo që nuk të ka goditur, nuk do të mund të të godiste dhe se ajo që të ka goditur, nuk do të mund të të mos godiste. Po ashtu, ta dish se fitorja është me durimin, çlirimi me mundimin dhe vështirësia me lehtësimin.”

[Sahih] [رواه الترمذي وغيره]

Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se njëherë kur ishte i vogël kishte hipur (mbi kafshë) me Profetin dhe ai i tha: "Unë po të mësoj disa çështje dhe gjëra, përmes të cilave Allahu do të të bëjë dobi: Ruaje Allahun duke i ruajtur urdhrat e Tij dhe duke iu shmangur ndalesave të Tij, në mënyrë që Ai të të gjejë duke bërë adhurime e të mos gjejë duke bërë mëkate. E, nëse e bën këtë, shpërblimi yt do të jetë që Zoti të të ruajë nga të këqijat e kësaj bote dhe të botës tjetër, si dhe do të të ndihmojë në punët e tua kudo që të shkosh. Nëse dëshiron të lypësh diçka, lypi vetëm Allahut, sepse vetëm Ai u përgjigjet kërkesave të atyre që e lusin. Nëse dëshiron ndihmë, mos e kërko prej askujt pos Allahut. Duhet të jesh i bindur se nuk do të kesh asnjë dobi, edhe nëse të gjithë njerëzit e tokës mblidhen për të të bërë ndonjë dobi, përveç asaj që ta ka caktuar Allahu, dhe anasjellas, nuk do të të ndodhë asnjë e keqe, edhe nëse të gjithë njerëzit e tokës mblidhen për të të bërë ndonjë dëm, përveç asaj që ta ka caktuar Allahu. Kjo çështje është caktuar nga Allahu i Lartmadhëruar dhe është vendosur sipas asaj që përkon me urtësinë dhe diturinë e Tij, e nuk ka ndryshim të asaj që ka caktuar Ai. Ai që e ruan Allahun duke i ruajtur urdhrat e Tij dhe duke u larguar nga ndalesat e Tij, atëherë Allahu i Lartësuar do të jetë përpara robit, e di gjendjen e tij, e ndihmon dhe e përkrah. Nëse besimtari i bindet Allahut në rehati, Allahu do t’i bëjë atij në kohë vështirësish rrugëdalje dhe lehtësim. Çdo njeri le të jetë i kënaqur me atë që Allahu ia ka caktuar, qoftë e mirë apo e keqe. Gjatë sprovave dhe vështirësive, njeriu duhet të durojë, sepse durimi është çelësi i lehtësimit; kur vështirësia bëhet e rëndë,

lehtësimi vjen nga Allahu, dhe kur vjen vështirësia, Allahu e pason atë me lehtësim.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/66522